



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:148291
Datë: 27.05.2024
Numri i dokumentit: 05739503

Ac.nr.7004/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Feka - kryetar i kolegjit, Arsim Hamzaj dhe Besnik Bisalimaj - anëtarë të kolegjit, në çështjen jokontestimore të propozuesit A. M. nga fshati R.-Komuna e K., të cilët me autorizim e përfaqëson F. T. avokat nga K., kundër kundëpropozuesit Qeveria e Kosovës (Organi Shpronësues) MMPH Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson Nexhmije Karaqi avokate shtetërore, për caktimin e kompenzimit për pasurinë e eksproprijuar, duke vendosur sipas ankesës së kundëpropozuesit parashtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Kacanik, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.16/20, të datës 14.07.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më **20.05.2024**, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET SI E PA BAZUAR ankesa e kundër propozueses Qeveria e Kosovës-Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me seli në Prishtinë, ushtruar përmes përfaqësuesit nga Ministria e Drejtësisë-Avokatura Shtetërore në Prishtinë, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik me numër CN.nr.16/20, dt: 14.07.2021, **VËRTETOHET.**

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Ferizaj-Dega në Kacanik, Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e Cn.nr.16/20 të datës 14.07.2021 ka vendosur si në vijim:

- I. APROVOHET si i bazuar propozimi i propozuesit A. M. nga fshati R. Komuna e K. dhe ndryshohen Akt-vlerësimet e Qeverisë së Kosovës-organit shpronësues të datës 05.09.2016, për ngastrat kadastrale 221-0 dhe 226-0 , në pronësi të propozusi sa i përket çmimit dhe
- II. CAKTOHET kompenzimi në shumë prej 8.804.00 euro në emër të diferencës për pjesën e shpronësuar dhe vlerës së humbur për pjesën e pa shpronësuar, për ngastrat kadastrale me nr.

221-0 dhe 226-0, të evidentuara në çertifikatën e pronës me nr. të lëndës 714-3577/2016 Z.K-
rekë edhe atë:

- Në emër të vlerës financiare-diferencës për pjesën e shpronësuar të ngastrës kadastrale 221-0, në sipërfaqe prej $294 \text{ m}^2 \times 4.40 \text{ euro/m}^2 =$ në shumën prej 1.293.60 euro;
- Në emër të vlerës financiare për pjesën e shpronësuar të ngastrës kadastrale 226-0 në sipërfaqe prej $340 \text{ m}^2 \times 4.30 \text{ euro/m}^2 =$ në shumën prej 1,462.00 euro;
- Për dëmin e pësuar-vlerën e humbur për pjesën e mbetur jashtë shpronësimit të ngastrës kadastrale nr.221-0, në sipërfaqe prej $426 \text{ m}^2 \times 28.40.00 \text{ euro/m}^2 = 12.098.40 \text{ euro} \times 50\% =$ në shumën prej 6.049 euro;

III. URDHËROHET, kundërpropozuesi –Organi Shpronësues Republika e Kosovës-Qeveria e Kosovës që propozuesit A.M. nga fsh.Rekë i'a kompenzoj shumën prej 8.804.00 euro, këtë shumë me kamatë prej 7% duke filluar nga data 09.11.2016, (datën e vendimit përfundimtarë) e deri në pagesën definitive.

IV. DETYROHET, kundërpropozuesi që propozuesit të i'a paguaj shumën si në pikën II të këtij dispozitivi si dhe shpenzimet e procedurës jokontestimore në shumë prej 1. 499.00 euro, këto pagesa do të bëhen në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit në dorzim të këtij aktvendimi, nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur kundërpropozuesi, për shkak shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar, ta prish aktvendimin e atakuar ashtu që ta refuzojë propozimin e propozuesit si të pabauar në ligj, ndërsa ta lë në fuqi Venimin Përfundimtar nr.03/115 të datës 09.11.2016 si dhe Akt Vlerësimin e datës 05.09.2016 si të bazuar në ligj.

Propozuesi ka ushtruar përgjegjje në ankesën e kundërpropozuesit duke kundërshtuar në tërësi pretendimet ankimimore e propozimin që Gjykata e Apelit ta refuzojë ankesën si të pa bazuar ndërsa ta vërtetojë Aktvendimin e atakuar me ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimimore lidhur me aktvendimin e ankimuar, shqyrtimit dhe analizimit të provave në shkresat e lëndës, e në mbështetje të nenit 194, 208 dhe 209 pika (b) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), në pajtim me nenin 3 të Ligjit për Procedurën Jokontestimore (LPJK-së), konstatoi se:

Ankesa e kundër propozueses Qeveria e Kosovës-Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me seli në Prishtinë, ushtruar përmes përfaqësuesit nga Ministria e Drejtësisë-Avokatura Shtetërore në Prishtinë, është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se i autorizuari i propozuesit, si në propozimin me shkrim edhe në seancat e mbajtura gjyqësore, ka kërkuar nga Gjykata që propozimi i tij të miratohet në tërësi

si i bazuar, dhe të caktohet kompenzimi në shumë prej 8.804 euro, edhe atë në emër të diferencës për pjesën e shpronësuar dhe dëmit të pësuar për pjesën e mbatur jashtë shpronësimit. - Në emër të vlerës financiare-diferencës për pjesën e shpronësuar të ngastrës kadastrale 221-0, në sip. prej $294 \text{ m}^2 \times 4.40 \text{ euro/m}^2 =$ në shumën prej 1.293.60 euro, në emër të vlerës financiare për pjesën e shpronësuar të ngastrës kadastrale 226-0 në sip. prej $340 \text{ m}^2 \times 4.30 \text{ euro/m}^2 =$ në shumën prej 1,462.00 euro. Për dëmin e pësuar-vlerën e humbur për pjesën e mbetur jashtë shpronësimit të ngastrës kadastrale nr.221-0, në sipërfaqe prej $426 \text{ m}^2 \times 28.40.00 \text{ euro/m}^2 = 12.098.40 \text{ euro} \times 50\% =$ në shumën prej 6.049 euro. Këto shuma me kamatë prej 7% duke filluar nga data 09.11.2016, e deri në pagesën definitive. Ka kërkuar që të caktohet kompenzimi sepse me rastin e shpronësimit nuk është caktuar çmimi real ashtu siç është përcaktuar me nenin 15 par.1 dhe 2 si dhe nenin 18 par 3 të Ligjit të nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluejtëshme. Shpenzimet i ka kërkuar.

Gjykata seancën gjyqësore e ka mbajtur në mungesën e kundërpropozuesit sepse e njejta ka qenë e ftuar me rregull, mungesën nuk e ka arsyetuar dhe nuk ka kërkuar shtyrjen e shqyrtimit gjyqësorë.

E autorizuar e kundërpropozuesit, në seancat në të cilat ka prezentuar dhe parashtrësit me të cilat është deklaruar për seancë i ka propozuar gjykatës që propozimin ta refuzojë në tërësi si të pa bazur. Ka theksuar se kundërpropozuesi e ka vlersuar në mënyrë reale pronën e shpronësuar dhe i ka propozuar gjykatës që me rastin e vendosjes ta merr për bazë aktvlerësimin e kundërpropozuesit. Po ashtu e ka kontestuar edhe raportin e vlersimit të përpiluar nga eksperti vlersues duke theksuar se çmimi i caktuar për kompenzim nga vlerësuesi është i lartë në krahasim me çmimin e caktuar nga Organi Shpronësues –Qeveria e Rep.të Kosovës. E ka kundërshtuar edhe kompenzimin e pronës së pa shpronësuar sepse konsiderojmë se e njejta është në kundërshtim me vendimin përfundimtarë të Qeverisë së Rep.të Kosovës me nr.03/115 i dt.09.11.2016, ku në nenin 5 të këtij vendimi të cilin vet propozuesi e kundërshton është cekur se kompenzimi i përket vetëm lartësisë së shumës së kompenzimit të përcaktuar me këtë vendim, dhe askund nuk është shënuar se pala e pa kënaqur kundër këtij vendimi mund të paraqesë ankesë për kompenzimin e tokës që iu ka humbur vlëra me rastin e shpronësimit. Shpenzimet nuk i ka kërkuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas propozimit, ka caktuar seancë gjyqësore dhe pas administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar C.nr.16/20 të datës 14.07. 2021 me të cilin e ka aprovuar si të bazuar propozimin e propozuesit, duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në arsyetimin e këtij aktvendimi, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se paluejtshmëria e shpronësuar evidentohet në emër të propozuesit, këtë fakt Gjykata e vërtetoi nga çertifikata e pronës me nr. të lëndës 714-3577/2016, në të cilën është shënuar se kjo pronë evidentohet në emër të A. (A.) M. nga fshati R.. Pasuria e propozuesit është shpronësuar për interes publik, këtë fakt Gjykata e ka vërtetuar nga vendimi përfundimtarë Nr.03/115, të datës 09.11.2016, ku në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi është shënuar se bëhet shpronësimi i pronave të paluejtshme të pronarëve për realizimin e projektit me interes publik-ndërtimi i autostradës R6

Prishtinë -Hani Elezit. Palët ndërgjygjëse gjatë procedurës së shpronësimit nuk kanë arritur marrvëshje për lartësinë e kompenzimit, këtë fakt gjykata e ka vërtetuar nga deklaratat e palëve ndërgjygjëse të cilat kanë deklaruar se nuk kanë arritur marrvëshje sa i përket pagesës së kompenzimit, për arsye se shuma e ofruar për kompenzim është e ulët dhe nuk është sipas çmimit të tregut. Kompenzimi i caktuar me aktvlersimet e kundërpropozuesit të datës 05.09.2016 (për PK.nr.221-0 dhe 226-0), nuk ishte real dhe sipas çmimit të tregut, këtë fakt Gjykata e ka vërtetuar nga raporti i vlerësimit të ekspertit vlerësues Avni Salihu i cili ka gjetur se çmimi real për kompenzimin e ngastrës kadastrale 221-0 është 28.40 euro, për m², ndërsa për ngastrën 226-0 është 18.30 euro/m² e jo çmimi sipas aktvlerësimit të kundërpropozuesit. Se nga ky shpronësim propozuesi ka pësuar dëm, sepse pjesës së mbetur i ka humbur vlera, këtë fakt Gjykata e ka vërtetuar nga ekspertiza dhe plotësimi i ekspertizës së ekspertit vlerësues Avni Salihu, i cili në ekspertizën dhe plotësimin e sajë ka konstatuar se pjesa e mbetur e pa shpronësuar e ka humbur vlerën në krahasim me gjendjen e më parshme, sepse ndërtimi i autorstradës në anën jugë lindore të ngastrës pikërisht në ballë të ngastrës ka bërë që këto ngastra ta humbin vlerën e sajë, sepse tani nga shiqimi i parë nuk shihet pejsazhi i natyrës, është zvogëluar sipërfaqet e pronës si tërësi, ku në të ardhmën kjo pjesë e sipërfaqes nuk mund të shfrytëzohet për truall-oborr, sepse tani e tutje kufizohen me autostradën. Kjo është sqaruar në raportin bazë të punuar më datën 04.04.2017 në faqen 11 të raportit.Po ashtu ndikim në humbjen e vlerës së kësaj pjese kanë pengesat fizike të cilat janë humbja e pozitës , formës dhe madhësisë (sepse kanë mbetur vetëm 426 m²) gjithashtu ndikim kanë edhe kufizimet ligjore që kanë të bëjnë me aspektin ligjorë të shfrytëzimit të ngastrave për gjatë brezit mbrojtës të rrugës. Me ligjin numër 203/11, Ligjin për Rrugët dhe Ligjin numër 03/L/120 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Rrugët, neni 16 paragrafi 26.1 dhe 26.2 të këtijë Ligji , pronari humb të drejtën për shfrytëzimin e ngastrës për ndërtim në distancë prej 100 metra nga brezi mbrojtës i autostradës . Kështu që nëse pronari pretendon ta shfrytëzoj ose ta shis si truall-oborr blerësit do ta humbin interesimin, dhe si e tillë kjo pjesë e sipërfaqes së pa shpronësuar nuk mund të shfrytëzohet për veprimtari të ndryshme, dhe e ka humbur vlerën në shkallë prej 50%, e të cilit mendim gjykata ja dha besimin. Gjykata kësaj ekspertize ja fali besimin sepse vlerësuesi e ka aplikuar metodën e shitjeve krahasuese dhe kjo është sqaruar në faqen 8 dhe 9 të raportit të vlerësimit, po ashtu edhe në plotësimin e ekspertizës në faqen 2, por referencat e marrura janë paraqitur edhe në mënyrë tabelare nga anan e vlerësuesit. Gjykata pas administrimit të provave propozimin e propozuesit e miratoi në tërësi si të bazuar dhe e detyroi kundër propozuesin qe propozuesit t'ia paguaj shumën prej 8.804 euro, në emër të kompensimit, për vlerën financiare për pjesën e shpronësuar dhe për vlerën e humbur, për pjesën e pa shpronësuar e cila detalisht është përshkruar në pikën e I-rë të dipozitivit të këtij aktvendimi.

Gjykata ka vepruar sipas Udhëzimeve të Gjykatës së Apelit të dhëna me aktvendimin Ac.nr.3598/2017 të datës 06.07.2020, dhe e ka bërë plotësimin e ekspertizës nga anan e ekspertit dhe pastaj ka nxjerrur vendimin meritor me të cilin është miratuar propozimi i propozuesit. Me rastin e nxjerrës së këtij aktvendimi , gjykata i vlerësoi edhe theksimet e të autorizuarës së kundërpropozuesit të bëra gjatë seancave të cilat ka prezentuar dhe pretendimeve të bëra me parashtrësë , me të cilat i ka propozuar gjykatës që të refuzohet kërekesa për kompenzim sepse në nenin 5 të vendimit përfundimtarë nr.03/115 të datës 09.11.2016, është shënuar se propozuesi mund të paraqes ankesë pranë gjykatës kompetente vetëm sa i përket lartësisë së shumës së

kompenzimit të përcaktuar me këtë vendim. Këto theksime gjykata i refuzoi si të pa bazuara sepse me dispozitën e nenit 18 paragrafi 3 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme është paraparë se nëse si rezultat i shpronësimit pjesa e mbetur pëson humbje të vlerës (ose me arsye pritet se do të pësoj humbje të vlerës) pronari i pjesës së mbetur ka të drejtë të paraqesë ankesë në përputhje me nenin 37 të këtij ligji dhe të kërkojë nga gjykata kompetente nxjerrjen e aktvendimit me të cilin urdhërohet organi shpronësues që ta paguaj kompenzimin për humbjen e vlerës. Me rastin e miratimit të propozimit të propozuesit në shumën si në dispozitiv të aktvendimit, gjykata u bazua në ekspertizën e ekspertit vlerësues Avni Salihu dhe plotësimit të bërë e të cilës ekseptizë gjykata ja ka dhënë besimin e plotë sepse është përpiluar në mënyrë profesionale dhe conform dispozitave ligjore të cilat e rregullojnë këtë qështje, konfrom nenit 15 paragrafi 1 dhe 2 , nenit 18 par 3 dhe nenit 37 të Ligjit Nr.03/L-139 dhe Ligjit Nr.03/L-205 për ndryshimin dhe plotësimit e Ligjit Nr.03/L-139. Meqenëse kundërpropozuesi ka rënë në vonesë me pagimin e kompenzimit, gjykata në bazë të nenit 16 paragrafi 2 pika 2.2 të Ligjit mbi eksproprijimin e detyroi kundërpropozuesin që propozuesit në shumat e gjykuara t'ia paguaj edhe kamatën prej 7%, interes i thjeshtë vjetor, duke filluar prej datës 09.11.2016 (data e vendimit përfundimtar) e gjer në pagesën definitive . Gjukata e obligoi kundërpopozuesin që propozuesit të i'a paguaj shpenzimet e procedurës bazuar në nenin 19 të Ligjit për Eksproprijim si dhe nenit 222 të Ligjit për Procedurën Jokontestimore.

Gjukata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm pasi që aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (n) e LPK-së, dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjukata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë as në shkelje të tjera të dispozitave të procedurës kontestimore dhe jo kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Në këtë kuptim, gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes në këtë çështje jo kontestimore, drejtë dhe në mënyrë të plotë ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe jo kontestimore, ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, e si rezultat i kësaj, drejtë ka zbatuar edhe të drejtën materiale, për të cilat arsye, aktvendimi i atakuar është dashur të vërtetohet në tërësi. Gjithashtu, edhe dispozitivi i aktvendimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktvendimit, duke krijuar kështu harmoni logjike e juridike mes dispozitivit e arsyetimit. Përkatësisht, i njëjti është hartuar në përputhje të plotë me nenin 160, lidhur me nenin 175 të LPK-së. Gjukata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare, e në lidhshmëri me këtë, ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, përveç atyre jo kontestuese, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Për këto arsye, refuzohen si të pabazuara pretendimet ankimore të palës kundër propozueses, të cilat ndërlidhen me çështjet e cekura më lartë.

Me rastin e shqyrtimit të aktvendimit të atakuar dhe të ankesës së parashtruar, Gjukata e Apelit i vlerëson si të pabazuara pretendimet e palës ankuese për arsye se nga provat e administruara nga gjykata e shkallës së parë, përkatësisht nga ekspertiza e ekspertit vlerësues Avni Salihu dhe Plotësimit të Raportit të Vlerësimit të datës 21.06.2021, ka rezultuar se organi shpronësues për

shpronësimin e ngastrave kadastrale që janë objekt shqyrtimi në rastin konkret nuk e ka vlerësuar sipas çmimit apo vlerës reale në treg, ndërsa nga ekspertiza e ekspertit vlerësues rezulton se për këto ngastra, përkatësisht vlera reale e çmimit për pjesën e ngastrën kadastrale nr. 221-0 të shpronësuar në sipërfaqe prej 294 m² e cila është shpronësuar nga organi shpronësues me çmimin 24 euro, sipas vlerësimi të ekspertit vlera reale e kësaj paluajtshmërie është 28.40 euro për m², andaj në emër të diferencës për pjesën e shpronësuar të ngastrës numër 221-0 në sipërfaqe prej 294 m² e cila diferencë del të jetë shuma prej 4.40 euro për m² në total shuma prej 1.293,00 euro, ndërsa pjesa e mbetur jashtë shpronësimit në sipërfaqe prej 426 m² ka humbur vlerat e saj për 50% dhe nga përlllogaritja e vlerës së reale e ngastrës së shpronësuar e cila vlerë është 28 euro totali kap vlerën 6.049,00 euro. Për ngastrën kadastrale nr.226-0 sipërfaqja të shpronësuar prej 340 m² nga organi shpronësues me çmimin 14 euro, sipas vlerësimi të ekspertit vlera reale e saj është 18,30 euro për m², ashtu që diferenca e vlerës financiare për pjesën e shpronësuar është 4.30 euro për m² ashtu që toali kap vlerën prej 1.462,00 euro

Në lidhje me këtë, për caktimin e shumës së kompensimit të paluajtshmërive të shpronësuara dhe zvogëlimit të vlerës së atyre të pa shpronësuara, gjykata e shkallës së parë, me të drejtë i ka falur besimin ekspertizës dhe plotësimit të ekspertizës të datës 21.06.2021, e cila ekspertizë në fjalë është përpiluar në pajtim me dispozitat ligjore të cilat i rregullojnë këto çështje, konform nenit 15 paragrafi 1 dhe 2, nenit 18 paragrafi 3 dhe nenit 37 të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e pronës së paluajtshme dhe Ligjit Nr.03/L-205 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-139.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, e mbështet plotësisht edhe gjykata e shkallës së dytë, për arsye se ajo me të drejtë ka vlerësuar se me rastin e shpronësimit me vendimin përfundimtarë të kundërpropozuesit, ngastrat kadastrale nuk janë vlerësuar realisht nga pala kundërpropozuese, ku me rastin e vendosjes gjykata ka marrë për bazë caktimin e ekspertizës së ekspertit vlerësues të caktuar nga gjykata për rivlerësimin e çmimeve për paluajtshmërive të shpronësuara dhe pjesën që ka mbetur jashtë shpronësimit, të përcaktuar në Raportin e Vlerësimit, i cili duke iu referuar të gjitha shkresave të lëndës, ka vlerësuar se për sipërfaqen e shpronësuar për sa u përket pjesëve të shpronësuara të ngastrave kadastrale të specifikuar si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar si dhe për zvogëlimin e vlerës një pjese të pashpronësuar rezulton të jetë vlerë tjetër reale e përcaktuar sikurse në ekspertizën e ekspertit të vlerësimit të pronave.

Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar se nuk janë vlerësuar realisht ngastrat kadastrale dhe këtë fakt e ka vërtetuar me raportin e vlerësimit dhe plotësimin e raportit të vlerësimit të datës 21.06.2021, të ekspertit vlerësues Avni Salihu, ku i njëjtit ka dhënë mendim profesional, duke vlerësuar në mënyrë të gjithanshme, dhe duke sqaruar mbi bazën e çfarë parametrave dhe kushteve i ka dhënë këto vlerësime.

Gjykata e Apelit vë theks të vecantë se Plotësimi i Raportit të Vlerësimit është bërë konform vërejtjeve të dhëna nga Aktvendimi Ac.Nr. 3589/2017 i datës 06.07.2020. Njëherit eksperti vlerësues në raportin vlerësues të tij ka sqaruar se e ka shfrytëzuar mundësinë për të bërë një studim dhe analizë lidhur me volumin e transaksioneve-shitblerjeve të paluajtshmërive në një

periudhë brenda 3 viteve të kaluara e gjerë më tani, por meqë është fjala për periudhë të caktuar duke zbatuar nenin 5, pika 4 të udhëzimit Administrativ nr.02/2015, të datës 07.08.2015 për miratimin e metodave dhe kriterëve të vlerësimit që përdoren për përlllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin, eksperti është shërbyer edhe më të dhëna shtesë dhe ka analizuar edhe të dhënat e siguruar nga kontratat e shitblerjeve duke analizuar edhe rrethanat e tjera faktike. Tutje në ekspertizën e tij, eksperti vlerësues ka sqaruar se për caktimin e çmimit real është shërbyer me të dhënat faktike lidhur me çmimet e aplikuara nga organi shpronësues për pronat brenda zonës ku ndodhen edhe paluajtshmëritë lëndore në rastin konkret ku edhe ka bashkangjitur të dhënat nga Qeveria e Kosovës, Ministria e Finacave, Departamenti i Tatimit në Pronë. Gjykata e shkallës së parë, të njëjtës ekspertizë me të drejtë ia fali besimin, andaj edhe Gjykata e Apelit e ka pranuar në tërësi qëndrimin dhe përfundimin e gjykatës së shkallës së parë përkitazi me vendosjen meritorë dhe refuzoi të gjitha pretendimet ankimore të kundërpropozuesit të paraqitura me ankesë si pretendime të paqëndrueshme, duke vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Meqë aktvendimi i atakuar është vërtetuar në tërësi për atë që është vendosur lidhur me shumën e kompensimit, atëherë automatikisht vërtetohet edhe vendimi i gjykatës së shkallës së parë lidhur me shpenzimet procedurale, të cilat gjykata e shkallës së parë i ka caktuar në bazë të dispozitës së nenit 222 të LPJ-së, ndërsa vendimin për kamatën e ka marrë në bazë të nenin 16 paragrafi 2, nën paragrafi 2.2 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme

Gjykata e Apelit i mori parasysh edhe të gjitha pretendimet të tjera ankimore, por të njëjtat nuk patën ndikim në vendosjen ndryshe nga kjo që është vendosur.

Nga të lartcekurat, e në mbështetje të dispozitave nga nenet 194 dhe 195.1, pika d), lidhur me nenin 200, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr7004/2021, datë 20.05.2024

**Kryetari i kolegjit-Gjyqtari,
Besnik Feka**